

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË** – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil nga Gjykatësi **Drilon HARAÇIA** dhe me pjesëmarrjen e sekretares juridike Valbone Hoxha, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses K.- SH.A - Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari L. M., me autorizim në shkresat e lëndës, kundër të paditurve A. B. H. dhe A. B. H. që të dy nga Gjakova rr. “I. S.” p.n, për kompensimin e dëmit material, vlera e kontestit të precizuar 586,22 €, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.09.11.2018, në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të paditurve, **me dt.05.12.2018**, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I.MIRATOHET** në tërësi kërkesë – padia e paditëses K.- SH.A - Prishtinë, ashtu që të **DETYROHET** i padituri i dytë A. B. H. nga Gjakova, që në emër të kompensimit të dëmit material t’ia paguaj shumën prej **586,22 €**, (**pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë euro e njëzet e dy cent**) me kamatën përkatëse ligjore 8% në vitë, e cila fillon të rrjedhë nga dt.18.09.2016, (zgjerimi i kërkesë-padisë) e tutje, gjer në pagimin definitiv, si dhe në emër shpenzimeve procedurale shumën prej 15,00 euro, e te gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së Aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

**II. MIRATOHET** tërheqja e padisë së paditëses K.- SH.A – Prishtinë, e parashtruar kundër të paditurit të parë A. B. H. nga Gjakova, për kompensimin e dëmit, në kuptim të nenit 261 të LPK-së.

### **A r s y e t i m**

Pala paditëse në padi dhe në zgjerim të kërkesë-padisë, nëpërmes të autorizuarit të saj dhe gjatë shqyrtimit të kësaj çështje ka theksuar se mbetem në tërësi pranë padisë duke shtuar se meqenëse i padituri i dytë ka bërë disa pagesa dhe me procedurën penale është vërtetuar se i njëjti ka qenë shkaktar i dëmit të cilin nuk e ka mohuar duke premtuar se do ta bëjë pagesën e dëmit, i propozoi Gjykatës që padinë ndaj të paditurit të parë A.H. ta konsideroi të tërhequr për shkak të legjitimitetit, ndërsa mbesim në tërësi pranë kërkesë padisë ndaj të paditurit të dytë A. B. H.. Andaj propozoi gjykatës që të bëhet administrimi i provave.

I autorizuari i paditëses në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë së precizuar, në shqyrtimet e mëhershme gjyqësore i padituri e ka pranuar fajësinë për dëmin e shkaktuar si dhe i njëjti ka paguar mbi gjysmën e dëmit të shkaktuar, ndërsa ka mbetur pa paguar pjesën e dëmit të cilin e kemi precizuar. Andaj baza juridike e kërkesë padisë dhe lartësia nuk është kontestuese nga se kalkulimi është bërë në përputhje me Rregulloren e nxjerrur nga ZRRE për rikthimin e humbjeve. Andaj propozoi Gjykatës që kërkesë padinë ta aprovoi në tërësi si dhe i kërkoi shpenzimet gjyqësore si dhe kamatën ligjore 8%.

I padituri i parë në përgjigje në padi të dhënë me dt.18.07.2016, ka theksuar se i padituri nuk mohon faktin se lokalit ku është shfrytëzuar rryma elektrike e K., sipas orëmatësit elektrik nr. 17663212, e ka pasur në shfrytëzim një periudhë të caktuar së bashku me vëllain e tij A. H., e këtë

gjatë periudhës prej vitin 2010 e deri në vitin 2014. Para tyre këtë lokal e kanë shfrytëzuar personat tjerë. Po ashtu, pohon se me rastin e marrjes në shfrytëzim të lokalit në fjalë, ai nuk e ka konstatuar gjendjen ekzistuese të shfrytëzimit të rrymës elektrike nga shfrytëzuesit e mëparshëm por ka vazhduar shfrytëzimin e rrymës edhe ka bërë pagesat e faturave të K., sipas mundësive të tij materiale. Edhe pse në vazhdimësi ka mohuar faktin se nuk ka marrë asnjë veprim përkitazi me shfrytëzimin ilegal të rrymës elektrike, i padituri ka qenë i detyruar nga komisioni i K., për ta nënshkruar procesverbalin me rastin e heqjes së orëmatësit të rrymës elektrike, me dt. 08.05.2013, në të kundërtën sipas rekomandimit të tyre do ti ndërpritej shfrytëzimi mëtutjeshëm i rrymës elektrike.

I padituri i dytë nuk ka dhënë përgjigje në padi edhe përkundër detyrimit të kësaj Gjykate sipas Aktvendimit C.nr.275/16 të dt.11.08.2017 të cilin e ka pranuar së bashku me padinë, zgjerimin e kërkesë-padisë dhe provat me dt.27.08.2017.

Gjykata me aktvendimin procesor të dt.25.10.2017 ka miratuar propozimin e palës paditëse për zgjerimin e kërkesë-padisë kundër të paditurit të dytë në kuptim të nenit 258.1 të LPK-së.

Gjykata në shqyrtimin kryesor duke u bazuar në deklarin e të autorizuarit të paditëses ka miratuar tërheqjen e padisë kundër të paditurit të parë A. H. nga Gjakova, në kuptim të nenin 261 të LPK-së.

Gjykata shqyrtimin kryesor e ka mbajtur në mungesë të paditurve të cilin kanë qenë ftuar në mënyrë të rregullt ndërsa mos prezencën nuk e kana arsyetuar, ndërsa me propozimin e palës paditëse Gjykata shqyrtimin e ka mbajtur në kuptim të nenin 423.4 të LPK-së.

Gjykata pas vlerësimit të fakteve juridiko-relevante të kësaj çështje, çmuarjes së provave materiale, dhe në mbështetje të nenit 8 të ligjit për Procedurën Kontestimore nr.38/2008, vërtetoi se kërkesë-padia e paditëses e precizuar është në tërësi e bazuar dhe si e tillë u miratua.

Gjykata në procedurën e administrimit të provave bëri shikimin dhe leximin e provave si: procesverbalit me nr. 12227 të dt. 13.08.2013, të lëshuar nga K. si dhe 8 foto në formatin A4 në fotokopje bardhë e zi, ku shihet fotografimi i njëisorit bllobave, Fatura me nr. ... të lëshuar nga K. të dt. 27.11.2013, Procesverbali me nr. ... të dt.27.08.2012, të lëshuar nga K., Procesverbali me nr. ... të dt. 20.11.2013, Procesverbali i Gjykatës Themelore në Gjakovë, i procedurës penale me nr. P.nr. 337/14, të dt.18.01.2016, Transakcioni i konsumatorit me nr. ... të dt. 05.10.2015, dhe transakcioni dt. 11.09.2018.

Nga provat e administruara u argumentua gjendja faktike si më poshtë:

Baza e kërkesë-padisë u vërtetua nga provat e administruara si Procesverbali i Gjykatës Themelore në Gjakovë, i procedurës penale me nr. P.nr. 337/14, të dt.18.01.2016 dhe transakcioni i konsumatorit ku i padituri i dytë e ka pranuar që të bëjë kompensimin dhe me një formë e ka pranuar se ka qenë shkaktar i demit, po ashtu kjo u vërtetuar edhe me pagesat e kohëpaskohshme të cilat i ka kryer i padituri i dytë duke e zbritur lartësinë e demit nga shuma prej 796.22 € në shumë prej 568.22 €.

Lidhur me lartësinë e kërkesë-padisë kjo gjykata e vërtetoi në bazë të provave si Fatura me nr. ... të lëshuar nga K. të dt. 27.11.2013, Transakcioni i konsumatorit me nr.... të dt. 05.10.2015, ku dëmi i shkaktuar ka qenë në shumën prej 796.22 €, ndërsa meqenëse i padituri i dytë ka bërë pagesa të kohëpaskohshme shuma e dëmit ka zbritur në shumë prej 568.22 €.

Gjykata pas vlerësimit dhe analizimit të provave veç e veç erdh në përfundim se kërkesë-padia e paditëses e precizuar duhet aprovuar në shumën prej 568.28 €, me kamatën përkatëse ligjore, në bazë të provave të administruara në shqyrtimin kryesor duke u bazuar në nenin 136 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se *“kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muarr konform nenit 452.1 të LPK-së, me ç’rast paditësit iu pranuan shpenzimet në lartësi prej 15,00 euro, të cilat i referohen taksave gjyqësore.

Nga të lartcekurat u vendos si në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**C.nr.433/18 të dt.05.12.2018.**

**GJYKATËSI,**  
**Drilon HARAÇIA**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij Aktgjykimi lejohet e drejta e ushtrimit të ankesës, në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.